



# Misioni ynë

Revistë informative, kulturore dhe shpirtërore, viti III, nr. 9, janar-mars 2023



## Festa dhe realiteti

Faqe 3

(Foto: iStock)



**Misioni Katolik Shqiptar**  
**Katholische Albanische Mission**

**LUZERN**

## faqe

REVISTË INFORMATIVE, KULTURORE  
DHE SHPIRTËRORE E MISIONIT KATOLIK  
SHQIPTAR NË LUZERN



### **SELIA E REVISTËS**

Rodteggstrasse 6, CH-6005 Luzern  
St. Michael



anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch  
albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch  
ukas\_cr@hotmail.com



<https://www.misioni-lu.ch/>



[https://www.facebook.com/ Misioni Katolik  
Shqiptar - Luzern](https://www.facebook.com/Misioni%20Katolik%20Shqiptar%20-%20Luzern)



### **TË NDIHMOJMË REVISTËN**

Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3  
Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 |  
6005 Luzern

### REDAKSIA

**Dr. Don Anton Uka** – kryeredaktor

**Motër Vida Ademi** – koordinuese

**Veneranda Qerimi** – redaktore e teksteve

**Mirlinda Dushi Berisha** – përgjegjëse për  
intervista

**Gjane Simoni** – asistente

**Motër Mrika Sabedini** – asistente

### **3 EDITORIALI**

Festa dhe realiteti

### **8 AKTIVITETET E MISIONIT**

Takimi me gratë e Misioneve Katolike  
Shqiptare në Zvicër

### **14 AKTUALITET**

Dëshmia e don Samuelit

### **16 INTERVISTA**

Intervistë me Motër Vida Ademi

### **18 PËRSHPIRTËRI**

Bedeutung der Karwoche - Heilige Woche

### **20 EDUKIM**

Gruaja – vlerë e shoqërisë

### **22 PSIKOLOGJI**

Dashuria nuk të bënë të vuash

### **24 KISHA NË BOTË**

Testamenti shpirtëror i  
Papa Benediktit XVI

### **31 RECENSION**

Etika e komunikimit

## Festa dhe realiteti

Pashkët janë festë gëzimi dhe galdimi, festë kur Kisha e krishterë kremtorisht feston dhe këndon këngën “Aleluja”, që e përkthyer në gjuhën shqipe do të thotë: lëvdojeni Hyjin. Duke parë gjithë këtë mjerim që e ka kapluar njerëzimin dhe duke pas parasysh dhunën, luftërat dhe rreziqet që aq shumë po e kanosin botën, dikush me të drejtë mund të pyet: a mund të flitet sot për gëzim, harmoni, optimizëm, shpresë, dashuri.

Pashkët i bëjnë thirrje secilit njeri për ta bërë kapërcimin e nevojshëm dhe të domosdoshëm nga e keqja, në të mirë. Sikur që më ndërrimin e stinëve ndryshon edhe natyra në përgjithësi, me Pashkët dominon dhe zotëron e mira dhe e vërteta në çdo njeri, dimri i jetës sonë shndërrohet në pranverë, marrëdhëniet e ftohta, të ngrira apo të vdekura që mund të kemi ndaj vetvetes, ndaj njëri-tjetrit apo edhe ndaj Hyjit, shndërrohen në marrëdhënie të ngrohta, të mira, të gjalla dhe të dashura, sepse për të krishterët “Krishti është jetë dhe vdekja fitesë” (Fil 1, 21). Pa këtë kapërcim nuk mund të ketë festë të vërtetë. Pa këtë kalim festa dhe realiteti gjithmonë do të mbeteshin larg dhe në kundërshtim me njëra-tjetrën.

Pashkët janë festë e ngadhënjimit mbi skllavërinë. Të jetosh nën skllavëri, do të thotë të mos jesh vetvetja, pikërisht për faktin se dikush tjetër, në mënyrë arbitrare, vendos për fatin e jetës tënde. Heqja e lirisë, në kuptimin biblik, është shkelja më e madhe që mund t'i bëhet dinjitetit njerëzor. Kjo është arsyeja pse Hyji edhe atëherë kur ne e keqpërdorim lirinë dhe ia kthejmë shpinën Atij, nuk na braktisë dhe nuk pushon duke na dashur. (krah. Lk 15, 11-32)

Bota, mjerisht, vazhdon të ketë sisteme të shumta diktatoriale që për parim dhe synim kanë heqjen e lirisë njerëzore. Mëkati e lidhë shpirtin e njeriut dhe e pengon të ngritët në lartësitë qiellore, për të cilat është krijuar. Misteri i Pashkëve dëfton se Krishti vdiq për mëkatet tona dhe vdekja nuk ka pushtet mbi Të.

Pashka e Krishtit kështu bëhet festë e jetës mbi vdekjen, e shpresës mbi dëshpërimin. Dëshpërimi është gjendje e rënduar shpirtërore dhe mendore që për pasojë ka mbylljen e njeriut në mendime të këqija dhe pengon paqen dhe lumturinë në jetën tonë. Dëshpërimi e bën të pamundur që njeriu të shikojë përtej situatës në të cilën gjendet dhe nxit brenda tij frikë dhe trishtim. Sot shumë njerëz vuajnë simptome të tilla. Festa e Pashkëve na fton ta njohim, ta pranojmë dhe ta dëgjojmë të Ringjallurin, i cili erdhi për të na liruar nga trishtimi dhe frika (krah. Lk 24, 13-35).

Pashkët, më shumë sikur asnjë festë tjetër, janë festa e ngadhënjimit të jetës mbi vdekjen. Ky është lajmi më i mirë dhe më shpresëdhënës që në vete përmban fuqinë ta shndërrojë jetën e njeriut përbrenda. “Lajmi i mirë se Jezusi u ringjall, do të thotë për ne se dashuria e Zotit është më e fortë se e keqja dhe vetë vdekja; do të thotë se dashuria e Zotit mund ta transformojë jetën tonë, t'i bëjë ato zona të shkreta të lulëzojnë në zemrën tonë”, thotë Papa Françesku.

Uroj që festa e Pashkëve të na lirojë nga skllavëria e mëkatit, nga dëshpërimi dhe nga të gjitha ato gjëra që sjellin thatësi dhe vdekje në jetën tonë mendore, shpirtërore dhe ndërnjerëzore.

Gëzuar e për shumë mot Pashkët!

*Don Antoni*



## KREMTIMET E KRISHTLINDJES NË MISIONIN TONË

(Foto: Gësisika Simoni)

**N**ë vigjiljen e Krishtlindjes në Misionin tonë në Luzern Mesha shenjte është kremtuar në tre vende të ndryshme: në orën 18:00 në Getnau, në orën 20:00 në Emmenbrücke dhe në orën 23:00 në Inwil. Ndërsa në ditën e Krishtlindjes Mesha shenjte është kremtuar në orën 10:30 në Goldau dhe në orën 13:30 në Sursse. Në të gjitha këto kremtime prania e besimtarëve ishte mjaft e madhe dhe kishat ishin të mbushura me besimtarë.

Gjatë këtyre ditëve të shenjta ishte i ftuar don Shtjefen Dodes, drejtori i Radio Marisë së Kosovës, për të ndihmuar në kremtimin e Mes-hës shenjte por dhe për të rrëfyer besimtarët të cilët nuk kishin arritur të rrëfeheshin ditët në të cilat kanë qenë përcaktuar rrëfimet. Gjithashtu don Shtjefni ka transmetuar drejtpërdrejt Mes-hën shenjte nga kisha në Emmenbrücke në Ra-dio Mari por edhe ditën e Krishtlindjes nga Ki-sha e Shën Gjergjit në Surssee.

Në festën e Krishtlindjes kremtojmë lindjen e Jezu Krishtit, i cili erdhi në tokë, duke u mis-hëruar për ne dhe për shpëtimin tonë.

Kujtojmë se pas festës së Pashkëve, Krisht-lindja është festa më me rëndësi për ne të



(Foto: Nue Tuqi)

krishterët, sepse kremtojmë ardhjen e Zotit në mesin tonë, në personin e Jezu Krishtit.

Përveç kremtimeve liturgjike, Misioni ynë ka organizuar edhe festën familjare. Kjo festë u kremtua në sallën e madhe në Qendrën italiane Papa Giovanni në Emmenbrücke.

Të pranishëm ishin rreth 350 persona, kryesisht familjar. Ishte një festë shumë e bukur, në një atmosferë vëllazërore, miqësore dhe e këndshme. Atmosferën i dha jetë akoma më shumë edhe muzika dhe kënga shqipe e kënduar nga artisti Rajmond Prenaj. Po ashtu edhe ushqimet e shijshme si dhe shërbimi i bërë nga vullnetarët e Misionit tonë, që nën udhëheqjen e Pjetër Gjonit, u përkujdesen që gjithçka të shkojë mirë dhe mbarë.

Festat e tilla në Misionin tonë janë po ashtu një mundësi më shumë për të kultivuar traditën, gjuhën dhe vlerat tona familjare, fetare dhe kombëtare. Kjo është arsyeja kryesore e organizimit të festave dhe bashkimeve të tilla.

*Shkruan: Redaksia*



*(Foto: Nue Tuqi)*

## NDEJE E PËRBASHKËT

Të dielën, me 29 janar, pas Meshës në Emmenbrücke, në ora 16:00, anëtarët e Korit në Willisau me rrethinë, kanë organizuar një darkë të përbashkët në ambientet e bukura të qendrës famullitare të këtij qyteti.

Përveç ushqimeve të mira dhe shumë të shijshme, ishte një atmosferë e mirë dhe shumë miqësore.

Takimet e tilla na ndihmojnë të përafrohemi edhe më tepër me njëri tjetrin, të shkëmbejmë mendime dhe të marrim vendime për një funksionim edhe më të frytshëm të aktiviteteve tona baritore.

*Shkruan: Redaksia*



*(Foto: Gjoana Tuqi)*



## FESTA E ZOJËS SË LURDIT NË MISIONIN TONË

Foto: Kastriot Frokaj

**Z**oja e Bekuar iu shfaq Bernardetës së vogël në shpellën e Lurdit, një fshat i vogël në jug të Francës. Prandaj edhe e quajmë Zoja e Lurdit. Që prej asaj kohe ky vend i shenjtë është bërë qendër shpirtërore me përmasa

të mëdha, si vend në të cilin besimtarët marrin hire, bekime dhe shërim si meritë e ndërmjetësimi të Nënës së Jezusit. Për këtë fakt edhe Papa, Shën Gjon Pali i II, datën 11-të shkurti e caktoi si ditën e të sëmurëve që tani është edhe dita botërore e të sëmurëve, pikërisht në festën e Zojës së Lurdit.

Edhe në Misionin tonë në Luzern kjo festë është kremtuar solemnisht. Meshën shenjte në mbrëmje e ka kremtuar don Anton Uka, misionar. Prania e besimtarëve në Meshën shenjte ishte mjaft e madhe, kjo gjë bëri që edhe solemniteti të ishte edhe më i bukur. Gjatë Meshës shenjte don Antoni ka ndarë edhe sakramentin e vajimit të sëmurëve të cilët ishin të pranishëm në Meshën shenjte dhe të gjithë atyre që dëshiruan të marrin këtë sakrament të shenjtë, të cilin e pranuan shumica e besimtarëve të pranishëm.

Gjithashtu gjatë kremtimit të Meshës shenjte ishte edhe pagëzimi i Anja Maria nga Tirana.



(Foto: Kastriot Frokaj)



(Foto: Kastriot Frokaj)

Një vajzë 12-të vjeçare, që pati shprehur dëshirën për pagëzim së bashku me prindërit e saj, edhe pse prindërit i përkasin një tjetër besimi fetar. Kjo ngjarje e bëri solemnitetin liturgjik edhe më të veçantë.

Pas Meshës shenjte, së bashku me të gjithë besimtarët e pranishëm, me qirinjë dorë bëmë procesioni rreth kishës së famullisë St. Michael. Ishte një përvojë jashtëzakonisht e bukur, edhe besimtarët ishin shumë të entuziazmuar. Solemnitetin e ka zbukuruar edhe kori i Misionit, me praninë e shumicës prej tyre të cilët e përcollën këtë solemnitet me këngë dhe lutjen e të gjithë të pranishmëve.

Falënderojmë Zojen e Lurdit për këtë përvojë të thellë shpirtërore dhe për të gjitha hirit që pranojmë prej saj.

Virgjëres Mari, Nënës së ngushëllimit, ja porosisim të gjithë ata që vuajnë në trup dhe në shpirt, ata që janë duke përjetuar luftën e tmerrshme, ata që janë të përjashtuar nga fa-



(Foto: Nue Tuqi)

miljet, të vetmuarit dhe ata që janë të lenë pas dore, por edhe të gjithë ata që përkushtohen për t'ju ndihmuar personave që kanë nevojë për ndihmë.

Shkruan: m. Vida Ademi



(Foto: m. Mrika Sabedini)

**M**e 18-të shkurt kishim kënaqësinë të mirëprisnim në qendrën tonë në Luzern, gratë e Misionit Katolik Shqiptar të Thurgaut dhe të Aaraut.

Stafi i ngushtë i Forumit të grave të Misionit në Luzern, së bashku me don Antonin dhe Motrat, menduam dhe planifikuan këtë takim të përbashkët. Qëllimi i këtij takimi ishte që të takoheshim së bashku për të përjetuar disa momente shpirtërore dhe argëtuese me njëra-tjetrën. Për këtë takim, stafi i Forumit, së bashku me don Antonin dhe Motrat, mbajtën disa takime përgatitore në mënyrë që planifikimi dhe përgatitja të ishte sa më e mirë dhe e përzemërt, gjë të cilën e kemi arritur në kuptimin e plotë të fjalës.

Gjithashtu kemi kontaktuar edhe me Motrat e dy Misioneve të tjera, të cilat me kënaqësi pranuan pjesëmarrjen e grave të Misioneve përkatëse në takimin e organizuar nga ana jonë, gjë për të cilën i falënderojmë shumë.

Dita filloi me pritjen në orën 9:30, që ishte një pritje shumë e ngrohtë dhe e përzemërt. Fillimisht sikurse e ka edhe tradita jonë Shqiptare, grave ju është ofruar Kafë e shoqëruar me kiflë, pastaj m. Vida Ademi ju uroj të gjitha grave mirëseardhjen në misionin tonë duke i përshëndetur ato dhe duke bërë njëkohësisht edhe hapjen e programit. Motra paraqiti edhe programin e ditës si duke sh-

prehur edhe disa fjalë lidhur me angazhimin e Forumit të grave në Misionin e Luzernit.

Më fjalën e Mori Vjollca Bisaku, si kryetare e Forumit të Grave në Luzern, e cila bëri edhe një paraqitje të shkurtër historike për lindjen, formimin, dhe angazhimin e Forumit të Grave. Forumi i grave ka filluar aktivitetin e tij që në vitin 2001, kur edhe kanë ardhur motrat Bijat e Dashurisë Hyjnore në Mision këtu në Luzern dhe gratë menjëherë iu janë bashkuar Motrave dhe iu janë gjetur në ndihëm për gjithçka kanë pasur nevojë ato. Numri i Forumit të Grave ka filluar gjithnjë e më shumë të rritet, dhe së bashku me motrat kanë filluar të organizojnë takime të ndryshme, si ato shpirtërore, shtegtime, ditën e nënave dhe apero dhe kështu vazhdojnë punën e vet duke mos kur-



(Foto: m. Mrika Sabedini)



syer asgjë dhe duke mos treguar lodhje asnjëherë. Kujdes të veçantë tregojnë ndaj angazhimeve dhe aktiviteteve me qëllim humanitar, duke ndjerë dhimbje për të varfërit, të sëmurët dhe të gjithë nevojtarët. Aktivitet të cilin e bëjnë që prej formimit të tyre. Forumi i grave të Misionit tonë sot numëron rreth 80 gra që janë të gatshme për të kontribuar për nevoja të ndryshme.

Don Anton Uka na ftoi në meditim me temën: «Marta e Maria» (Lk 10,38-42). Pas leximit të kësaj pjese të ungjillit të Lukës, don Antoni ndër të tjera tha: «Marta është imazhi i secilit prej nesh kur jemi të shqetësuar me ose për «bërjen», «veprën», «vrapiimin». Maria, nga ana tjetër, është gruaja e dëgjimit. Ajo përfaqëson secilin prej nesh kur përpiqemi të «kuptojmë», «të reflektojmë», të «ndalojmë. Jezusi nuk dëshiron të krahasojë jetën soditëse me atë aktive. Nuk thotë se pjesa e Martës është e gabuar dhe ajo e Marisë është e duhura. Marta dhe Maria nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën, nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, por e plotësojnë njëra-tjetrën. Marta ka nevojë për Marinë, Maria ka nevojë për Martën. Jeta e lutjes ka nevojë për jetë aktive dhe anasjelltas. Marta dhe Maria përfaqësojnë dy mënyra jetese, të cilat duhet të gërshetohen me njëra-tjetrën. Secili person, është njëkohësisht, një Martë e vogël dhe një Mari e vogël. Duhet të bëjmë, por edhe të mendojmë, të meditojmë. Shpesh na ndjek urgjenca për të bërë. Gjithmonë ka shumë probleme konkrete për të zgjidhur. Edhe ne rrezikojmë të «stresohemi» dhe të harrojmë gjërat thelbësore. Ungjilli nuk na kërkon të zgjedhim mes Martës (veprimit) dhe Marisë (përsiatjes apo dëgjimit soditës), por, përkundrazi na fton të kombinojmë «të vepruarit» tonë



(Foto: m. Mrika Sabedini)



(Foto: don Anton Uka)

me «dëgjimin» tonë, për të përmirësuar «të qenit tonë në botë» gjithnjë e më shumë».

Dita vazhdoi me kremtimin e Meshës shenjte, e udhëhequr nga don Antoni. Menjëherë pas ishte dreka për të gjitha të pranishmet, ku gjithsej ishim rreth 200 persona. Dreka ishte e përgatitur nga qifti Kastriot dhe Vera Frrokaj, të cilët patën përgatitur një drekë shumë të mirë dhe me kosto minimale, domethënë aq sa ka kushtuar blerja e ushqimit, pa përfitime për shërbimin e kryer. Ndërsa Violeta Markaj si gjithmonë është e gatshme për të dhënë ndihmesën e saj, na solli mbulesat e tavolinave.

Të qenurit së bashku vijoi me muzikë live, ku gjatë gjithë kohës u shoqërua me këndimin e bukur nga këngëtari Dodë Kalaj, i cili së bashku me kolegen e tij nuk pranuan asnjë shpërblim për shërbimin e tyre.

Pas drekës u bë shërbimi me ëmbëlsira të ndryshme, shumë të shijshme dhe me fruta të sjella nga e Misionit tonë. Ndërkohë kemi shijuar bashkëndarjen interesante të kishin përgatitur për këtë rast nga Valentina Pernrecaj dhe Lume Malota, pjesëtare të Forumit të ngushtë të grave.

Falënderojmë Zotin për gjithçka që na ofron, për të gjitha të mirat në mënyra të ndryshme, falënderojmë don Anton Ukën, misionarin tonë, Motrat, Stafin e grave për punën dhe realizimin e kësaj dite të paharruar. Falënderojmë edhe mikeshat që erdhën në misionin tonë, për kohën e bukur që kaluam së bashku dhe të gjithë bashkëpunëtorët tanë. Zoti i shpërbleftë për të gjitha të mirat që bëjnë në shërbim të të tjerëve.

Shkruan: Vjollca Bisaku, Hochdorf



## PJATË PËR ÇDO TRYEZË

(Foto: nga Arkivi)

**F**orumi i Grave dhe Motrat e Misionit tonë, falë bashkëpunimit të mirë dhe përvojës shumëvjeçare, gjejnë kohë për tu bashkuar dhe për të krijuar gjëra të mira për ata që kanë nevojë për ndihma të ndryshme materiale apo shëndetësore.

Është viti i tretë më radhë që gratë bashkohen për të përgatitur pjatën dekoruese për festën e Pashkëve. Është vërtetë bukur dhe kënaqësi për të bashkëndarë diçka nga të mirat tona me njerëzit që nevojë për ndihmën dhe kontributin tonë. Pikërisht për këtë arsye, ne si bashkësi e Misionit në Luzern, veçanërisht në kohën e kreshmëve, organizojmë aktivitete të ndryshme që kanë për qëllim bashkimin tonë dhe bamirësinë.

Në pjatën e Pashkëve të këtij viti kemi vendosur disa simbole (qiriun, lepurin dhe vezët) të cilat kanë një domethënie të thellë shpirtërore.

Qiriu është simboli i Jezusit të ringjallur dhe përfaqëson dritën e Krishtit të gjallë që ngadhënjën mbi errësirën e vdekjes dhe të së keqes.

Lepuri është simboli i frytshmërisë dhe vigjilencës dhe prandaj është bërë edhe simboli i ringjalljes së Krishtit.

Veza është simboli i jetës. Në të fshihet ekzistenca e një qenie të re e cila depërton nga errësira e lëvizshme të fortë dhe del në dritë, ashtu

edhe Jezusi e shkatërroi shkëmbin e vdekjes dhe u zgjua në jetën e re.

Përmes këtyre tri simboleve të pranishme në pjatën e Pashkëve, urojmë dhe dëshirojmë që edhe në familjet tona të shndrisë drita e Krishtit të ringjallur, duke na mbushur me fryte të mira dhe kështu të largojë çdo të keqe dhe errësirë nga mendja dhe zemra jonë.

Gëzuar Pashkët!

*Shkruan: Valentina Prenrecaj, Root*



(Foto: Gjonita Lleshdedaj)



**M**bledhja e Keshilltarëve të Misionit tonë në Luzern, kësaj radhe filloi me darkën e përbashkët të ofruar nga Misioni ynë. Menjëherë pas darke filluam shqyrtimin e pikave të rendit të mbledhjes. Fillimisht u lexua dhe u nënshkrua procesverballi i mbledhjes së kaluar. Pastaj bëmë një reflektim dhe vlerësim të kreut të 30-të vjetorit të themelimit të Misionit në Luzern, që më solemnitet dhe dinjitet të madh u kremtua më 22 dhe 23 tetor të vitit të kaluar.

Të gjithë të pranishmit në mbledhje pohuan ecurinë e mirë të përgatitjes dhe të festës, duke theksuar, po ashtu, se përvojat e tilla na ndihmojnë që në kretime të tjera të jemi edhe më të përgatitur. U theksua se roli dhe kontributi i grupeve që e përbëjnë Misionin tonë,

si : Këshilli i Misionit, Forumi i Grave, Kori, Grupi i të rinjve, i fëmijëve, i vullnetarëve, është i pazëvendësueshëm për organizim dhe mbarëvajtje. Po ashtu u vlerësua edhe koordinimi i mirë i punës dhe i gjithë të angazhuarve në detyra të ndryshme.

Temë tjetër ishte koha e Kreshmëve, bekimi i familjeve, shtegtimi në Lourdes dhe Jerusalem, festa e Pashkëve dhe mbledhja e adresave të besimtarëve tanë.

Mbledhjet e tilla dhe të programuara janë një mundësi e mirë për të bashkëndarë ide, për të koordinuar punën dhe për të vlerësuar ecurinë e aktiviteteve tona të shumta shpirtërore, kulturore dhe argëtuese.

*Shkruan: Aida Avgustini, Ebikon*

### Aktivite bamiëse - Prerja e flokëve

Misioni ynë gjatë gjithë kohës ka një kujdes për nevojtarët, të cilët kërkojnë ndihmën tonë, që janë në halle të ndryshme familjare, ose me sëmundje të rënda. Kështu që gjatë kohës së kreshmëve bëjmë aktivitete të veçanta për të ndihmuar njerëzit që gjenden në situata të tilla. Më 25 shkurt në Misionin tonë u organizua aktiviteti i prerjes së flokëve për të gjithë ata që dëshirovan. Kontributi që ishte vullnetar dhe pa përcaktim të një çmimi për të gjithë ata që erdhën për të prerë flokët, mbledhet për njerëzit e përmendur më lart.

Njerëzit me zemër të madhe morën pjesë në këtë aktivitet, që janë specialist dhe të cilët e ushtrojnë këtë profesion. Ata punuan më përkushtim dhe dashuri deri në orët e vona të natës. Në këtë aktivitet morën pjesë: Anita Rosaj, Henrik Lushi dhe Albion Kamberi.



*(Foto: don Anton Uka)*

Në këtë mbrëmje janë bashkuar 930 - fr.

Falënderojmë Zotin dhe të gjithë ata që kontribuan për këtë aktivitet bamirësie. Falënderojmë edhe të gjithë ata që kanë pranuar të vinë dhe në këtë mënyrë të japin kontributin e vet për nevojtarët.

*Shkruan: Redaksia*



I shte ëndërr e imja realizimi i një Kampionati si ky i yni që u realizua në mbrëmjen e 18-të marsit në ambientet e Misionit tonë në Luzern. Gjërat e tilla janë të mundshme kur kemi lirinë për t'i shprehur idetë tona, përkrahjen për t'i konkretizuar ato, vullnetin për t'i organizuar dhe mjetet për t'i realizuar. Të gjitha këto, falë komunikimit të sinqertë dhe bashkëpunimit të mirë që kemi, nuk na munguan në realizimin e këtij kampionati.

Ideja që një kampionat i tillë të organizohej në ambientet e Misionit tonë Shqiptar në Luzern, lindi në një ditë dimri ndërsa po drekoja me dy shokët e mi, Zefin dhe Leonardin, të cilët më sugjeruan që të flisja me meshtarin, don Antonin, që sapo kishte ardhur për të shërbyer tek ne, në Luzern. Sipas tyre ai ishte personi i duhur dhe i gatshëm për bashkëpunim. Më pas biseduam me don Antonin i cili menjëherë e miratoi idenë time duke më sugjeruar që kampionati të behej në kohën e kreshmëve dhe të dedikohej për bamirësi. Kështu edhe ndodhi.

Edhe këtë vit me një sukses të madh u realizua kampionati, në të cilin morën pjesë 50-të shahistë dhe shumë shikues të grupmohave dhe nacionaliteteve të ndryshme. Organizimi, falë shoqërisë dhe bashkëpunëtorëve të mi ishte në nivel

dhe të pranishmit u ndanë shumë të kënaqur.

Pas 9-të ndeshjeve për secilin pjesëmarrës, pavarësisht konkurrencës së madhe, fitues u shpallën: vendi i parë Afrim Fejzullahu, selektor i Përfaqësueses së Kosovës në Shah; vendi i dytë Xhevdet Osmani; vendi i tretë Ismajl Velija

Fituesi i vendit të parë, Afrim Fejzullahu, për revistën Misioni ynë, u shpreh kështu: “Falënderoj Organizatorët e Kampionatit blic, në Shah që u zhvillua në Misionin Katolik Shqiptar në Luzern, Stafin ndihmës dhe të gjithë Sponsorët. Sidomos falënderoj për mikpritjen vëllazërore dhe punën e palodhshme që personat e angazhuar bënë në mënyrë që ky Kampionat Humanitar të organizohej në mënyrën më të mirë të mundshme. Respekt!”.

Finalisti i vitit të kaluar, Xhevdet Osmani, që këtë vit zuri vendin e dytë, përveç falënderimit, uroi që ky kampionat të mbahet dy herë në vit, tha kështu: “Misioni Katolik Shqiptar në Luzern të Zvicrës organizoi kampionat humanitar, organizatorët e këtij kampionati ishin Gazmend Dedaj dhe Don Anton Uka. Pjesëmarrja në këtë kampionat e Afrim Fejzullahut, kampion i shumëfishtë dhe selektor i shahut Kosovar si dhe e Don Antonit, bënë

që turniri të jetë interesant dhe madhështor. Pos stafit organizativ, falënderoj të gjithë pjesëmarrësit me shpresë që ky të bëhet kampionat tradicional dhe të luhet së paku dy herë në vit, këtë mendim e bashkëndanë të gjithë pjesëmarrësit. Falënderoj të gjithë, posaçërisht prijësin fetar, Misionarin dhe humanistin e shkëlqyer, don Antonin”.

Ndërsa fituesi i vendit të tretë, Ismajl Velija, për lexuesit e revistës sonë përçoi këtë mesazh: “Në një ambient shumë të këndshëm të Misionit Katolik Shqiptar në Luzern, më 18-të mars u mbajt një kampionat shahu. Prifti i kishës, Don Anton Uka, me pak fjalë por shumë domethënëse e hapi manifestimin duke shpjeguar se kampionati tashmë po bëhet tradicional dhe përveç karakterit garues ka qëllim bamirësie. Shuma e mbledhura, nga më shumë se 100 pjesëmarrës, do të shkojë për bamirësi, në atdhe. Më pas miku jonë, Gazmend Dedaj, gjithashtu në cilësinë e organizatorit, foli mbi rregullat me të cilat luhen të gjitha kampionatet e shahut. Gjithçka filloi më kohë dhe kaluam një mbrëmje vërtetë të mirë. Në fytyrat e të pranishmëve, jo vetëm të fituesve, pashë gëzim dhe ngazëllim të theksueshëm. Tani



(Foto: Gaspër Merturi)

që kampionati po bëhet tradicional, përshëndetja kryesore mbetet: mirupafshim vitin tjetër!”.

Në këtë kampionat grumbulluam 2610.- franga dhe 70 euro, të cilat do të dedikohen për bamirësi. Falënderoj të gjithë pjesëmarrësit, sponsorët dhe ata që na ndihmuan në mbarëvajtje.

Shkruan: Gazmend Dedaj, Grosswangen



(Foto: Gaspër Merturi)



## DËSHMIA E DON SAMUELIT

(Foto: Anonim)

**N**ë cilëndo shtëpi të hyni, më parë thoni: *'Paqa me këtë shtëpi!'* Po qe se është aty ndokush mik i paqes, mbi të do të zbresë paqja juaj! (Lk 10, 5-6)

Nga data 22 Shkurt deri më 05 Mars 2023, isha në Misionin Katolik Shqiptar në Luzern të Zvicrës, i ftuar nga Misionari Don Anton Uka, për të bërë bekimin e shtëpive dhe familjeve shqiptare, të cilat jetojnë në këtë Mision.

Vizita ime këtu, filloi me kremtimin e Meshës së Shenjtë, të Mërkurën e Përhime, me anë të së cilës fillojmë kohën e Shenjtë të Kreshmëve për këtë vit. Kohë që i paraprin festës së madhe të Pashkëve, të Ringjalljes së Zotit tonë Jezu Krishtit.

Bekimi i shtëpive dhe familjeve, konsiderohet si detyra apo aktiviteti kryesor baritor i Kishës Katolike, si kujdes ndaj familjeve për t'ju dërguar Paqen e Krishtit, paqe të cilën Ai vetë na e solli në botë. Bekimi nga fjala latine do të thotë «të thuash mirë» për dikë ose për diçka, të kërkosh prej Zotit të mira. Është një lavd Zotit për të ftuar ndihmë dhe mbrojtje prej Tij.

Për një meshtar, bekimi i familjeve është një

përvojë shumë domethënëse dhe e mrekullueshme. Të kalosh pragun e shtëpisë së një familje, do të thotë të hysh në intimitetin e asaj familje, e cila të pranon me gëzim dhe ndanë historinë dhe përvojën familjare me Meshtarin.

Bekimi apo takimi në shtëpi, dallon nga takimet që realizohen në famulli, apo në grupe dhe aktivitete të ndryshme kishtarë. Vizita e famullitarit apo një meshtari që kryen bekimin, ka kuptimin e një takimi mikpritës, bashkëndarje të jetës familjare, shprese, gëzimi dhe vuajtje familjare. Duke qenë se nga vizitat e tilla, edhe meshtari është më i afërt me familjet, ai arrin t'i njohë më mirë e t'i kuptojë edhe shqetësimet e sfidat me të cilat besimtarët ballafaqohen në jetën dhe përditshmërinë e tyre. Ai takon besimtarë të cilët ndoshta nuk i ka takuar asnjëherë më parë, dhe nëpërmjet këtij sakramentori të bekimit, përcjell mesazhin e Zotit tonë Jezu Krishtit, se Ai kujdeset për ta dhe dëshiron që ta bekojë jetën dhe historinë dhe mbi të gjitha familjet e tyre, që të jenë të shenjta.

Përvoja ime personale e bekimeve në Misionin Katolik Shqiptar në Luzern, tek familjet shqiptare, ishte një nga përvojat e mia më të bukura



(Foto: don Samuel Ramaj)

e më mbresëlënëse. Sepse kam takuar shumë besimtarë, familje, që asnjëherë më parë nuk i kam njohur. Mikpritja e tyre, afërsia ndaj meje si Meshtar i ri, kujdesi dhe dashuria që më dhuruan më kanë bërë të ndihem jashtëzakonisht mirë, që kam arritur të përcjell tek ta porosinë që Jezu Krishti na e ka dhënë, që të shkojmë në çdo shtëpi e t'i bekojmë duke e kërkuar paqen e Zotit për ta, e që kjo paqe të mbretërojë gjithmonë në jetën e tyre dhe familjet e tyre.

Ishte vërtetë kënaqësi, që t'i dëgjoja historitë e secilës familje, aktivitetet e punës së tyre, jetën familjare, kujdesin ndaj familjeve që kanë në atdhe, e mbi të gjitha edhe për kujdesin që tregojnë ndaj Kishës në vendin ku jetojnë, por pa e harruar edhe kujdesin që kanë për famullitë prej nga kanë ardhur nga Kosova.

Përveç bekimeve të familjeve, gjatë kohës që kam qëndruar në Misionin Katolik Shqiptar në Luzern, kam përjetuar shumë kremtime, duke filluar me Meshën e të Mërkurës së Përhime, Lutjet e Përsëritërisë së Udhës së Kryqit, gjatë ditëve të premte, e gjithashtu edhe me rrëfime për besimtarët të cilët kishin nevojë për këtë sakrament, që është përgatitje për këtë kohë të shenjtë.

Lutem për secilën familje që kam takuar dhe bekuar gjatë kësaj kohe, që Zoti ynë Jezu Krishti, t'i mbajë përherë në paqen dhe bekimin e Tij, e gëzimi i festës së madhe të Pashkëve që po vjen, t'i mbajë gjithmonë të mbushur me jetë e me Shpirtin Shenjt.

Zoti i bekoftë të gjitha familjet tona Shqiptare, e bekoftë jetën e punën e tyre!

*Shkruan: Don Samuell Ramaj, Prizren*

### Shqyrtimi i ndërgjegjes

“Kur të harroj ose të lë pas dore, kur fjalët e mia dhe të botës i vë përpara Fjalës Tënde, kur mendoj se jam i drejtë dhe i përçmoj të tjerët, kur përgoj të tjerët, o Zot, ki mëshirë për mua, mëkatarin.

Kur nuk kujdesem për të afërmit, kur jam indiferent para të varfërve e të vuajturve, të ligshëve e të braktisurve, o Zot, ki mëshirë për mua, mëkatarin.

Për mëkatet kundër jetës, për dëshminë e shëmtuar, që ia ndot fytyrën e bukur Kishës Nënë, për mëkatet kundër Krijimit, o Zot, ki mëshirë për mua, mëkatarin.


Për gënjeshtat e pandershmërinë time, për mungesën e transparencës dhe të drejtësisë, o Zot, ki mëshirë për mua, mëkatarin.

Për mëkatet e fshehura, për të keqen që u kam bërë të tjerëve, edhe pa e kuptuar, për të mirat që mund t'i kisha bërë e nuk i bëra, o Zot, ki mëshirë për mua, mëkatarin.”

*Papa Françesku*

# INTERVISTË ME MOTËR VIDA ADEMI

MOTËR E BASHKËSISË SË MOTRAVE TË BIJAVE TË DASHURISË HYJNORE



***Si fillim dua t'ju falënderoj për bashkëpunimin tuaj me mua si intervistuese e revistës "Misioni ynë"***

Faleminderit juve për shërbimin që bëni për Misionin tonë në Luzern.

***Motër Vida, do doja t'ju pyesja se si ishte fëmijëria juajë***

Jam fëmija i parë i prindërve të mi dhe më kanë dashur shumë të gjithë. Jam rritur në një fshat me emër Dunav 1400 metra lartësi mbidetare në malet e rrethit të Gjilanit, në një familje të madhe që e konsideronin vetën mysliman. Duhet të them se Islamizimi në atë zonë ka depërtuar vonë dhe për disa kohë njerëzit e atyre zonave kanë jetuar si laramanë. Me kalimin e kohës kanë filluar martesat e ndërsjellëta me myslimanët, kështu që ngadalë janë kthyer plotësisht në Islam, madje sot disa prej familjeve dhe të afërmeve të mi edhe janë radikalizuar.

Ardhja e motrave «Bijat e Dashurisë Hyjnore» të cilave ju përkas, e ka ndihmuar gjithë popullatën e asaj zone që ishte shumë e varfër. Ne, fëmijët shkonim rregullisht të motrat dhe ato na kanë pranuar shumë mirë, kanë filluar të na mësojnë mbi fenë, fillova të mësoja lutjet prej një libri të vogël dhe këtë e kam bërë në fusha e male duke ruajtur bagëtitë, sepse në shtëpi nuk kam guxuar të tregoj sepse më kanë penguar shumë familja. Për fat të mirë babai që ishte kundërshtari kategorik dhe më i madh dhe që kisha frikë shumë prej tij, atë kohë punonte jashtë vendit dhe disi arrija të shkoja tek motrat fshehurazi dhe të mësoja mbi fenë. Në moshë 16-të vjeçare jam pagëzuar nga m. Asumta Vulaj, sepse meshtari që përkohësisht vinte për të kremtuar Meshën shenjte nga Stublla e Epërme, për pagëzim kërkonte

lejen e prindërve, sepse isha minorene dhe nuk deshi të më pagëzonte, ndërsa motra dhe unë që ishim lodhur duke kërkuar prej meshtarëve pagëzimin, nuk pritëm më.

***Në cilën moshë e dëgjuat thirrjen e Zotit dhe si e pritën familja juajë***

Thirrjen e kam ndjerë që në moshë të re, atëherë kur kuptova se edhe unë mund të bëhem motër dhe pas pagëzimit tim, planifikuam me motrat të largohem nga shtëpia, pa i treguar askujt, përveç motrave. Thirrja ishte që unë e ndjeja vetën time si një motër dhe më duhej të luftoja shumë për këtë dëshirë që ishte e flakët deri edhe në dhënien e jetës sime. Asgjë nuk më ka interesuar më, përveç si ta arrija këtë qëllim. Motrat dhe jeta e tyre më kanë pëlqyer jashtëzakonisht shumë. Ato me jetën dhe punën e tyre ishin një shembull tepër i mirë për ne. Kanë ndihmuar dhe dashur çdo person pa dallim.

***Motër, më parë ju i takonit fesë Islame, më shumë respekt për të gjitha fetë ekzistuese, sa ishte e vështirë rrugëtimi që ju e kishit marrë dhe a ju ka ndodhur të ndjeni nevojën për tu dorëzuarë***

Si vajzë 16-të vjeçare pas pagëzimit me ndihmën e motër Asumta Vulaj u largova nga shtëpia pa i treguar askujt dhe shkuam në Manastir (Bitol) të Maqedonisë, në kuvendin e motrave tona. Pas dy diteve babai së bashku me dajën e vet, erdhi për të më kthyer në shtëpi. E kundërshtova shumë dhe ika në kapelë për tu lutur që Zoti të më shpëtonte prej babait, por më mori pa dëshirën time, edhe pse u mundova fizikisht ta kundërshtoja. Për këtë edhe më rrahu aq shumë sa që dy javë kam qëndruar në shtrat sepse nuk kisha forcë për të qëndruar në këmbë. Pas disa muajve me ndërmjetësimin e disa personave është ofruar don Gjergj Gjergji për të më ndihmuar që ta arrija atë



qëllim. Kështu që vendosëm për tu larguar nga shtëpia dhe për të shkuar në Lubjanë, në Slloveni – mendova të shkoja diku larg. Por pasi isha në moshë minore dhe babai nuk e dinte ku jam më kërkoi me polici. Kështu që pas disa muajsh herët në mëngjes erdhi policia te dera dhe më kërkoi dhe më tha se duhet të shkoja me ta për të më pyetur për disa gjëra dhe do të kthehesha përsëri në shtëpi. Kjo nuk ndodhi dhe mbeta disa ditë në rajonin policor, së bashku me disa vajza shumë problematike që kishin arritur në polici. Më pas, pasi isha qytetare e Kosovës, policia e Sllovenisë më përcolli dhe më dorëzoi në policinë e Kosovës në Prishtinë. Edhe këtu qëndrova disa ditë duke kundërshtuar kategorikisht kthimin tim në familje dhe duke duruar shumë fyerje. Edhe ata nuk deshën të më lënë në kuvend – thoshin nuk mund të qëndrosh në Kishë. Kështu pas disa ditësh më dërguan në Mitrovicë, në shtëpinë e fëmijëve bonjak, ose disa ishin edhe të gjetur e pa mbiemër. Në këtë institut qëndrova katër vjet e gjysmë dhe përfundova shkollën e mesme. Edhe pse pak e lodhur prej të gjitha gjërave të përjetuara, dëshira ishte e njëjtë, kështu që vendosa të largohem dhe të shkoja larg prej ish Jugosllavisë dhe shkova në Itali tek motrat Baziliane. Aty qëndrova disa muaj, sepse edhe pse më kanë dashur shumë dhe i kam dashur unë ato, nuk arrija ta kuptoja dhe ta pranoja ritin bizantin që ishte tek ato, kështu që jam kthyer në Kosovë e me ndihmën e don Gjergj Gjergjit jam lajmëruar tek motrat tona, ku jam edhe sot.

***Motër Vida, që nga koha që shërbeni në Zvicër sa jeni e kënaqur me pjesëmarrjen e të rinjve në aktivitetet e kishës***

Mendoj se të rinjtë në Zvicër se janë shumë të mirë, por problemi është se ata janë shumë të angazhuar me shkollë, me punë, me kurse e profesione të ndryshme dhe ndoshta e kanë pak të vështirë të marrin pjesë shumë në aktivitetet e Kishës, sepse kjo është punë vullnetare dhe falas. Megjithatë kur i kërkojmë janë të gatshëm

dhe këtë e kemi përjetuar sidomos gjatë kremtimeve të 30-të vjetorit të Misionit tonë vitin e kaluar.

***Cila ka qenë koha më e vështirë gjatë gjithë periudhës që jeni duke shërbyer për Kishën***

Jeta ka vështirësitë e veta, gëzimet e arritjet. Vështirësi të madhe nuk kam pasur. Mendoj se nëse e do thirrjen, Kishën, shërbimin, popullin të cilit i shërben, edhe vështirësitë e jetës të duken të lehta. Kështu që nuk kam ndjerë ndonjë vështirësi të madhe në Kishë, sepse edhe e dua shumë dhe gjithçka më duket jo e rëndë për Kishën.

***Motër unë jam shumë e lumtur që kam patur fatin të njihem me ju, si një person shumë pozitiv që je do të doja një mesazh shumë motivues nga ju, për të gjithë ata persona që sot mund të gjenden edhe në një kohë stresuese, depresive apo edhe mosbesues ndaj Zotit***

Mendoj se besimi në Zotin, e Birin e tij që erdhi për ne në tokë është shumë me rëndësi në jetë. Të dorëzohesh në duar të Zotit dhe të mbështetësh në të, duke besuar dhe shpresuar se Ai na do, na fal, na ndihmon, kujdeset për ne, atëherë edhe stresi dhe depresioni nuk do të na mundonte aq shumë, sepse jemi të dorëzuar në duar të sigurt, tek Zoti.

***Motër ju falënderoj nga zemra për këtë intervistë dhe ju uroj shumë shëndet dhe të gjitha të mirat në jetën tuaj!***

Falënderoj Zotin që më ka dhënë forcë të pranoj thirrjen e tij dhe më ka drejtuar gjatë gjithë jetës, falënderoj të gjithë ata që më kanë ndihmuar ta realizoj thirrjen time, të falënderoj edhe ty personalisht dhe të shpërbleftë Zoti me hiret e veta, për punën që bën për Misionin tonë.

*Intervistoi: Mirlinda Dushi Berisha,  
Ettiswil*



**D**ie Karwoche – auch «Heilige Woche» genannt – ist die Woche vor Ostern. Es ist die wichtigste Woche im Kirchenjahr. Die Kirche erinnert uns in diesen Tagen daran, warum und wie der Sohn Gottes gestorben ist, es ist der Beginn des Christentums.

**Zur Karwoche gehören:** Palmsonntag, Gründonnerstag, Karfreitag, Karsamstag, Ostersonntag.

An **Palmsonntag** ritt Jesus auf einem Esel nach Jerusalem. Dort wird bis heute ein besonderes Fest für Juden gefeiert - das Pascha-Fest. Zu dieser Feier kommen viele Juden nach Jerusalem. Sie wollen gemeinsam ihren Glauben feiern. Jesus war selbst Jude, weshalb er mitfeiern wollte. Die Leute freuten sich sehr darüber, dass Jesus zu ihnen gekommen war. Sie hatten gehört, dass er schon vielen armen und kranken Menschen geholfen und Wunder bewirkt hatte. Deshalb sahen sie ihn als ihren Retter an. «Gesegnet sei er, der kommt im Namen des Herrn!», riefen sie. Die Leute legten Kleidung und Palmzweige für ihn auf den Boden, um ihn zu ehren. Die Stadtoberhäupter hörten von dem Mann, den alle verehrten. Ihnen machte es Angst, dass ihr Volk Jesus wie einen König feierte. Deshalb wollten sie Jesus töten.

**Traditionen an Palmsonntag:** An Palmsonntag werden sogenannte Palmzweige, die zu Hause oder in der Pfarrei gebastelt werden, in den Gottesdienst mitgenommen und gesegnet. Der Palmzweig wird bis nächstes Jahr aufgehoben. Aus den ver-

brennten Palmzweigen vom Vorjahr wird die Asche genommen und im Gottesdienst an Aschermittwoch den Besuchern auf die Stirn gestreut. Dieser Akt symbolisiert, dass das Leben vergänglich ist.

Am **Gründonnerstag** feierte Jesus zusammen mit seinen 12 Aposteln – seinen Jüngern - das Abendmahl. Während des Essens zerbrach er das Brot, um es mit seinen Aposteln zu teilen. Ebenso teilte er den Wein mit ihnen. Aber Jesus war besorgt - er ahnte, dass ihn jemand an die Stadtoberhäupter verraten würde. Er wusste auch, dass er getötet würde, indem man ihn an ein Kreuz nagelt. Er sagte zu seinen Aposteln: «Einer von euch wird mich ausliefern, einer, der mit mir isst.» Doch da wusste Jesus auch schon, dass er stärker sein würde als der Tod. Deshalb sagte er seinen Aposteln, dass er zurückkehren und in die Stadt Galiläa ziehen würde. Alle Apostel schworen, dass sie Jesus nie verraten würden. Aber dann passierte es doch: Judas, einer der Apostel Jesu, verriet ihn an die Stadtoberhäupter und zeigte ihnen, wo Jesus war. Als Lohn dafür bekam er Geld. Jesus wurde festgenommen.

Nach seiner Gefangennahme wurde Jesus vor den Stadthalter Pontius Pilatus gebracht. Dieser soll über Jesus richten. Da die Pharisäer es schafften, die Menschen gegen Jesus aufzustacheln und die Menge schliesslich dessen Tod forderte, sprach Pilatus sein Urteil: Der Sohn Gottes wird gegeißelt und muss sein Kreuz selbst auf den Hügel Golgotha tragen. Dort wird er ans Kreuz genagelt.

**Traditionen am Gründonnerstag:** An Gründonnerstag wird die Messe des letzten Abendmahls gefeiert. In dieser Messe wird die rituelle Tradition der Fusswaschung an 12 Personen, welche durch die Gläubigen ausgewählt werden, durchgeführt. Diese Personen stehen symbolisch für die 12 Apostel. Mit dieser Geste kommt der Auftrag Christi an die Apostel klar zum Ausdruck, immer im Dienst der Gläubigen zu stehen.

**An Karfreitag** - am frühen Morgen, ein Tag nach dem gemeinsamen Essen - wurde Jesus zum Tode am Kreuz verurteilt. Die Soldaten flochten ihm ausstechenden Dornenzweigen eine Krone, die er zu tragen hatte. Sie schlugen ihn mit einem Stock und spuckten ihn an. Sie führten Jesus hinaus, um ihn an das Kreuz zu nageln. Ein Mann, der gerade vom Feld kam, half Jesus das Kreuz zu tragen. Kurz bevor er um die 9. Stunde (das ist um 15 Uhr) stirbt, ruft Jesus: „Vater, vergib ihnen, denn sie wissen nicht, was sie tun!“ Zitat: Lukas 23,34.

Als Jesus starb, waren seine Familie und Freunde sehr traurig. Ein Freund von Jesus mit dem Namen Josef bat darum, den toten Jesus mitnehmen zu dürfen. Er wickelte Jesus in ein Leinentuch und legte ihn in ein Grab. Um das Grab zu verschliessen, rollte er einen schweren Stein vor die Höhle, in der Jesu beigesetzt wurde.

**Traditionen an Karfreitag:** Am Karfreitag und Karsamstag werden nach katholischer Tradition die Glocken nicht geläutet. Der Karfreitag ist ein Trauertag. Aus diesem Grund schweigen die Kirchenglocken vom Gloria beim Abendmahl am Gründonnerstag bis zum Gloria in der Osternacht. Der Volksmund nutzt daher die Metapher «die Glocken fliegen nach Rom, um den Segen des Papstes zu holen».

Am **Karfreitag** wird kein Gottesdienst wie es üblich ist gefeiert. Der Altar ist abgeräumt, die Glocken schweigen, der Tabernakel ist leer – die Kirche gedenkt des Leidens und Sterbens Jesu. Neben dem Aschermittwoch ist der Karfreitag ein gebotener Fast- und Abstinenztag.

Am Karsamstag, dem Tag der Grabesruhe, be-

hält eine Wache das Grab im Auge, da die Pharisäer befürchten, einer der Jünger könnte den Leichnam mitnehmen. Gläubige beten am Grab, entzünden Kerzen und erwarten die Auferstehung. Mit der Feier der Osternacht, beginnt der Ostertag. Am Osterfeuer wird die neue Osterkerze entzündet, deren Licht im Kirchenraum verteilt wird. Das Osterfeuer ist ein Symbol für das Licht, was Christus mit seiner Auferstehung in die Dunkelheit dieser Welt bringt.

An **Ostersonntag** kamen einige Frauen zum Grabe Jesu, um ihn mit duftenden Ölen einzureiben. Sie erschraaken: Der schwere Stein, den Josef vor die Höhle gerollt hatte, war zur Seite gerollt. Jesus lag nicht mehr im Grab. Dort sass nur ein Engel, der den Frauen sagte, dass Jesus nicht mehr tot sei, sondern Gott ihn wieder lebendig gemacht habe. Sie sollen diese frohe Mitteilung allen weitersagen. Er sagte: «Er geht euch voraus nach Galiläa. Dort werdet ihr ihn sehen, wie er es auch gesagt hat.» Die Frauen flüchteten vor lauter Angst und erzählten niemandem davon. Jesus aber war tatsächlich wieder lebendig. Er begegnete Maria Magdalena, die aufgeregt zu den Jüngern lief und rief «Jesus lebt wieder!». Aber die Jünger glaubten ihr nicht.

**An Ostermontag geht** die Ostergeschichte von Jesus weiter. Denn traurig über den Tod Jesu, machten sich zwei von den Jüngern an Ostermontag auf den Weg in das Dorf Emmaus. Während sie sich unterhielten, kam Jesus hinzu und ging mit ihnen. Zunächst erkannten sie ihn nicht und hielten ihn für einen Fremden. Erst beim gemeinsamen Essen, als Jesus das Brot teilte, erkannten sie ihn. Aufgeregt eilten sie nach Jerusalem zurück, um allen davon zu erzählen.

Ostern ist ein Symbol für Neuanfang, Erneuerung und Auferstehung.

An dieser Stelle wünsche ich allen frohen und gesegnete Ostern mit euren Liebsten.

*Bergita Krasniqi, Luzern*



## GRUAJA – VLERA E SHOQËRISË

(Foto: pikabay)

**G**ruaja dhe roli i saj në shoqërinë tonë akoma edhe sot, nuk trajtohet me vëmendjen dhe rëndësinë e duhur, as në familje, as në punë, as nga organet drejtuese institucionale dhe qeverisëse, e as nga shoqatat sociale dhe civile të cilat ngrihen dhe funksionojnë në emrin e saj. Në shoqërinë e sotme, gruaja dhe roli i saj përballet dhe vihet në diskutim vazhdimisht, duke ngjallur reagime dhe polemika sa herë në kronikat e aktualitetit dhe të veprimtarive sociale-politike bëhet me dashje, dhe pa dashje, protagoniste kryesore e ngjarjeve dhe dukurive shoqërore. Figura e gruas, ende sot, vazhdon të mos shihet, të mos pranohet, të mos respektohet, të mos vlerësohet, e të mos ndihet e dashur për atë që është. Në të shumtën e rasteve, harrohet që është përgjegjësi etike e morale për çdo individ që gruaja, së pari të vlerësohet për atë që është. E këtë gjë, përditshmëria na e vërteton gjithnjë e më shumë, ku ajo vazhdon të përballet me sfida herë - herë të pamundura, me dhunë fizike, seksuale, po ashtu edhe psikologjike, si; përdhunim, vrasje, keqkuptim, keqtrajtim, nënçmim, përbuzje, nënshtrim, përjashtim, dhe me mungesë vlerësimi për atë që është, e nuk po them edhe për atë që bën. Sepse po të shkruhet se çfarë bën

një grua nga mëngjesi herët e deri në orët e vona të natës, nuk do të rrëfenim mjaftueshëm.

Kështu që, nuk mund të përshkruhet se sa sakrifikon, sa dhurohet, sa angazhohet, sa duron një grua vetëm për tjetrin; për ty familje, për ty burrë, për ty fëmijë, për ty vëlla e motër, për ty koleg\e, për ty shok e shoqe, për ty mik e mi-keshë, për ty shoqëri në përgjithësi që shpesh herë e lë braktisur mënjanë. Megjithatë, edhe pse sakrifikon, dhurohet pa u ndalur, pa u lodhur, pa u ankuar, me keqardhje e me shumë dhimbje, duhet thënë e madje fort, se mjerisht akoma edhe sot diskutohet për rolin e gruas, funksionin që ajo ka në jetë ! E dhimbshme, dhe e pa konceptueshme!

Mendoj se nuk është më koha, dhe nuk është më e nevojshme, të diskutohet për një gjë të tillë. Ajo që është shumë e nevojshme, e dobishme dhe që kërkon angazhim, vetëdijësim e reflektim (jo diskutim, sepse për fjalë të bukura të gjithë jemi të zotët), është nevoja urgjente që të ndalesh e ta pyesësh veten ti si prind, ti si burrë, ti si bir e bijë, ti si drejtues shpirtëror, ti si punëdhënës, ti si pronar, ti si drejtor, ti si politikan...: «- A e vlerësoj, respektoj atë dhe dinjitetin e saj?

A e mbështes, përkrah, ndihmoj, gruan për atë që është dhe bën?! A arrij t'ia jap asaj vendin që meriton, në familje, në punë, në institucionet e edukimit, në politikë dhe në shoqëri? A e ndihmoj të ndihet grua në tërësinë e qenies së saj? A jam kontribues që të vlerësohet e respektohet qenia dhe dinjteti i gruas për atë që është? A ndihmohet gruaja të ndihet grua me të gjitha vlerat, virtetet pse jo edhe me dobësitë e saja? A mbështetet gruaja për përgjegjësitë që ka...?»

Nisur nga ajo se çfarë dëgjohej, çfarë lexohet, çfarë informacionesh transmeton masmedia, e çfarë shihet çdo ditë në shoqëri, është shumë e dukshme dhe e qartë se figura e gruas vazhdon të mos vlerësohet për atë që është. Për të flitet ende në mënyrë sipërfaqësore, nuk respektohet qenia dhe dinjteti i saj, nuk vlerësohet për vlerat e virtetet dhe për ekzistencën e saj, e aq më pak, për atë që ajo bën. Thënë kështu, pasi nuk kalon ditë që nuk dëgjohej se si një grua u dhunua, u përdhunua, një grua u vra, u vetëvra, u helmua... se si i mohohen të drejtat, detyrat, si nënvlerëohet, si poshtërohet, si keqpërdoret. Duke i dëgjuar të gjitha këto, e pashmangshme që të mos krijohet ideja, se ende sot, gruaja konsiderohet si objekt, e çka është më e rëndë, një gjë e tillë duket se askujt nuk i bën aspak përshtypje, e as në më të paktën të ngrejë pyetjen dramatike se: Çfarë po ndodh me gruan?! Të shqetësohemi dhe të reagojmë, kur kuptojmë se arsyeja që preferohet emri i përgjithshëm «femër», për ta identifikuar gruan, e jo «grua», është e qëllimshme, pse ajo mbart në vetvete një dallim domethënës e shpesh jo të gjithëpranueshëm. Kur thuhet thjesht «femër», kuptimi i saj është shumë i përgjithshëm, duket se theksohet më fort kuptimi biologjik i saj, përcaktimi gjinor e riprodhues (i përdorur gjithashtu jo vetëm për njerëzit), përkundrajt saj, fjala «grua» mbart në vetvete një kuptim më fuqplotë, më të thellë, dhe më kuptimplotë.

Pra, gruaja, është një qenie njerëzore delikate, e ndjeshme, e brishtë, por me një forcë të papërshtatshme. Është e pajisur me një finesë e modesti, është ajo që ekuilibron, e menaxhon çdo

situatë. Ajo është themeli e shtylla e shoqërisë. Gruaja, është figura nga e cila mësohet shumë, për lumturinë, gëzimin, dashurinë, mbështetjen, e gjithashtu për sakrificën, durimin dhe dhurimin pa kushte. Sepse, ajo nuk kursehet në asgjë, është përgjegjëse përballë çdo sakrifice e çdo munde e mbi të gjitha, ajo mundohet të gjejë arsye pozitive përballë çdo situatë. Ajo është bekim për vendin, për familjen për shoqërinë. Në Bibël e gjejmë të shënuar për gruan që thotë: Është shumë më e çmueshme se gurët e paçmueshëm (Fu.31, 10b). Vlera e saj nuk mund të matet, nuk mund të peshohet, e nuk mund të krahasohet, me asgjë. Gruaja është ajo që i jep shije çdo gjëje. Është ajo që nuk ndalet vetëm në fjalë por çdo gjë e paraqet në vepër. Është ajo që i reziston çdo kohe vetëm e vetëm, për të mirën e familjes dhe të tjetrit. Është ajo, që nuk ka frikë të shohë në sy, nuk ka frikë të përballë me çfarëdo lloj sfide. Është ajo, që di të jetë shoqe, kolege, mike. Ajo, është çdo gjë për secilin pjesëtar të familjes. Ajo është dritë, është dhuratë. Është mburoja mendore dhe shpirtërore aty ku është dhe vepron. Pra, mos ngurroni t'ia jepni gruas nderin, respektin, dashurinë dhe çdo gjë tjetër që asaj i takon dhe e meriton. Mos u kurse, e mos ki frikë, se nuk varfërohesh nëse i bëni këto.

- Ti grua, vlerësoje veten për atë që je, sepse je dhurata më e bukur që Zoti e krijoi e për këtë, ji krenare! Mos ki frikë, ta pranosh e ta shfaqësh dinjtetin tënd, mos ki frikë, të thuash jo apo ta ngresh zërin nëse nuk respektohet dinjteti e qenia jote. Angazhohu, mbroje, ruaje atë me fanatizëm! Qëndro kokë lartë, për atë që je! Kujdesu për veten, e mos ngurro t'i shpalosësh virtetet dhe vlerat që ke brenda vetes! Mos ki turp e frikë, t'i thuash vetes dhe tjetrit edhe kur nuk vlerësohesh për atë që je dhe bën, ji krenare dhe e kënaqur, sepse je grua. Je vetë mrekullia!

- Kurrë mos ki frikë të jesh vetvetja. Vlerësoje veten për atë që je!

*Shkruan: m. Franciska (Suzana) Lekaj,  
psikologe*



(Foto: pixabay)

## DASHURIA NUK TË BËN TE VUASH

**1** 4-të shkurti është dita e Shën Valentinit apo e të dashuruarve, dhe të dashuruarit e në veçanti çiftet, sepse kjo ditë ju referohet më shumë dashurisë romantike, bëjnë një gjest për ta shënjuar këtë ditë dashurinë e tyre edhe përmes një veprimi si bërjes së një dhurate, dhurimit të një lule apo ndonjë forme tjetër. Secili e kupton pak a shumë se edhe kjo festë ka rënë në kurthin e komercializimit, ku është kthyer në një shqetësim më shumë për të shpenzuar sesa një manifest i vërtetë dashurie, tani në këtë datë ne njerëzit si qenie sociale të ndikuar, edhe nga rrjetet sociale, e baras-vlerësojmë këtë festë doemos me një imazh të caktuar që na është ekspozuar nëpër rrjete sociale. Duhet thënë dhe përmendur për t'u mos keqkuptuar se dashuria ka edhe nevojë për këto gjeste, shprehje dashurie, dhe ato janë ujitje për lidhjen por vetëm atëherë, kur si frymëzim kanë burimin e brendshëm më shumë sesa diktimin nga jashtë. Prandaj, në këtë artikull do të flasim mbi dashurinë, nëse do të na pyesnin të vegjlit, fëmijët, se çfarë është dashuria si do t'i përgjigjeshim? Çfarë është ajo? Si mund t'i ndihmojmë ata por edhe veten për ta kuptuar se kur një dashuri është e vërtetë? Si ta kuptojnë dy të rinj kur ajo që po krijojnë ata është dashuri e pastër? Çfarë është dashuri e vërtetë? Për çfarë na nxit dhe inkurajon ajo?

Le të imagjinojmë sikur jemi duke shkuar në një vend, qytet apo fshat dhe kur arrijmë aty na mirëpresin, na pyesin për udhëtimin, na ofrojnë me dashmirësi diçka për të pirë, nuk ju intereson sesi dukemi, çfarë kemi veshur as çfarë do të themi, aty nuk ndjehemi nën trysnin që t'i impresionojmë ata dhe të fitojmë simpatinë e tyre, pak a shumë një vend ku mund të jemi vetvetja! E kemi të vështirë edhe ta imagjinojmë, sepse na duket shumë e bukur për të qenë e vërtetë, që s'ka të bëjë me ne, një vend i lumtur, e kemi të vështirë edhe ta imagjinojmë,

sepse në marrëdhëniet ndërnjerëzore ne jemi gjykuar dhe presim të na gjykojnë, jemi kritikuar dhe kemi frikë të na kritikojnë ose bëhemi vetë ne ata që kritikojmë, kemi mbështetur njëri-tjetrin me aq shumë kushte sa që ideja e një dashurie të pakushtëzuar na duket e pakonceptushme. Prandaj shohim shpesh se sikur në shumë forma të dashurisë, edhe në një marrëdhënie ne e duam tjetrin nëse bën gjërat që na pëlqejnë ne, nëse vepron ashtu si duam ne, nëse është i kujdesshëm me fjalët që të mos na turpërojë, kështu duke hyrë në një rrugë të gabuar dashurie, me tendencë për ta kontrolluar tjetrin, duke shfrytëzuar pasiguritë e tjetrit, e kështu duke u shqetësuar vetëm sesi ai/ajo na bën të ndjehemi e më pak sesi ndjehet ai/ajo. Pra, derisa dashuria e kushtëzuar ndërtohet mbi fjalën nëse, pra unë do të hyj në një lidhje, mbaj një lidhje dhe shfaq dashuri vetëm nëse personi bën ose nuk bën disa gjera të caktuara. Ndërsa dashuria e pakushtëzuar, në anën tjetër, është dashuri pa kushte. Është lloji i dashurisë që s'ka rendësi çfarë bën tjetri, personi tjetër do të jetë aty për ta dashur. Dhe me të drejtë mund të pyesni, sesi mund t'i duam pa kushte njerëzit dhe atëherë kur janë gabim. A nuk duhet të flasim për gabimet që bëhen, a duhet pranuar ato? Dhe po, është e vërtetë që disa gjëra duhet të përmirësohen dhe korrigjohen, por kjo nuk ndodh duke u shprehur me ndjenja zemërimi dhe dëshpërimi, sepse këto dy mënyra dëftojnë se dashuria nuk është e vërtetë, dhe kjo mënyrë e të "këshilluarit" me zemërim dhe të dëshpëruar, nuk tregon që na intereson tjetri por tregon që nuk kemi marrë atë që kemi dashur. Pra, kur duam pakushte nuk do të thotë se ne i përgjigjemi çdo kërkesë të tjetrit dhe jemi përgjegjës për gjithçka që ata dëshirojnë, sepse kjo do të ishte e dëmshme dhe e papërgjegjshme, por do të thotë se nevojat dhe emocionet e tjetrit janë të rëndësishme për mua, dhe ne i pranojmë ata ashtu siç janë, duke i ndihmuar në

mënyrën më të mirë në momente të caktuara. Dashuria e pakushtëzuar ndërtohet mbi frazën “Ne do ta gjejmë një mënyrë për ta zgjidhur këtë vështirësi”, prandaj dashuria e pakushtëzuar është një prej elementeve kryesore të një dashurie të gjatë dhe të shëndetshme.

Derisa po flisnim për dashurinë e pakushtëzuar, ne vumë re se pjesë e saj është dhe mënyra sesi flasim me njëri-tjetrin. As çiftet dhe as prindërit nuk duhet të harrojnë se mënyra sesi komunikojnë ata me njëri-tjetrin, është mënyra sesi reflektohet dashuria te fëmijët dhe mënyra më e mirë sesi e modelojnë konceptin e dashurisë, mënyra si i flasin njeri-tjetrin, si i trajtojnë dinamikat e ndryshme, qofshin zënka të ndryshme apo pakënaqësi, mënyra sesi i zgjidhin problemet dhe sesa respekt tregojnë në çdo situatë për njeri-tjetrin. Pra, mënyra e komunikimit dhe respektit ndaj njëri-tjetrit është një formë tjetër e pranisë së dashurisë reale, të sinqerte, autentike, kur dinë të komunikojnë përpara se të ikin e të krijojnë një atmosferë të pakëndshme, kur dinë të komunikojnë edhe për gjëra që janë të vështira por me edukatë, kur ndihmojnë dhe vlerësojnë njëri-tjetrin. Komunikimi tregon po ashtu sesa të lidhur jemi emocionalisht me tjetrin, dhe emocionet janë ngjitësi që lidh marrëdhëniet së bashku, dhe po ju mund të keni biseda të mrekullueshme mbi jetën, politikën, qëllimet, sportet, por nëse aty s’ka lidhje emocionale aty s’do të ketë as tërheqje të qëndrueshme. Kështu komunikimi shpreh këto emocione, por më shumë se kaq vetë emocionet janë gjuha e dashurisë. Përmes emocioneve ne shprehim ndjenjat më të thella të gëzimit apo frikës. Dhe dashuria në një lidhje do të thotë që të shprehësh këto emocione në mënyrë që ju lidh me njëri tjetrin dhe ju përgjigjen ndjenjave të partnerit me mbështetje, besim dhe respekt. Si pjesë shumë e rëndësishme e komunikimit është edhe dëgjimi, dhe në kohët e sotme ne shpërqendrohemi nga shumë informacione si dhe nga prania e telefonave, dhe shohim përditë se njerëzit në përgjithësi, por edhe çiftet qëndrojnë së bashku vetëm fizikisht, ata nuk janë prezent dhe nuk ju kushtojnë vëmendje njëri – tjetrit, dhe të dëgjuarit është formal, jo aktiv, në përpjekje për ta kuptuar vërtetë tjetrin e për t’u përfshirë në ndjenjat e njëri-tjetrit, gjë që bën të lindin probleme në të ardhmen dhe ata as te mos kuptojnë se nga erdhën këto probleme. Dëgjimi aktiv, të qenurit prezent, angazhimi në lidhje, vëmendja e kushtuar ndaj njëri-tjetrit janë një tjetër element i rëndësishëm i një dashurie reale dhe të pjekur.

Kur flasim për dashurinë mund edhe ta themi se po jetojmë në një krizë dashurie, ose në një botëkuptim të ri shumë të përhapur në ditët e sotme, që dashuria nuk është afatgjate. Është krijuar një besim

i përgjithshëm se është e pamundur të qëndrosh dhe të duash gjatë ose përgjithmonë. Grekët e lashtë kanë folur e shkruar shumë mbi dashurinë, ata klasifikonin disa forma të dashurisë, në lidhje me dashurin në çifte ata klasifikonin dy dashuri, EROS apo dashuria pasionuar dhe PRAGMA apo dashuria e përkushtuar. Eros është definicioni më i mirë i konceptit të sotshëm të dashurisë romantike. Sipas grekëve ky lloj dashurie është shumë e fuqishme dhe intensive, udhëhiqet nga epshi, kënaqësia dhe pasioni. Ata e quanin edhe një dashuri që të verbon, apo të bën që ta humbësh kontrollin, për çfarë grekët e lashtë e konsideronin se nuk ishte gjithmonë diçka e mirë dhe e nevojshme, sipas tyre kjo është një dashuri që rrezikon të shuhej shpejt. Ndërsa PRAGMA përshkruhet si e pjekur, dashuri realiste që gjendet në lidhjet e gjata apo të qëndrueshme. Për grekët e lashtë pragma ishte një harmoni e veçantë ndërmjet dy personave. Derisa dashurinë pasionuese, erodin e konsideronin si formë për të gjetur dashurinë, pragma është për të dhënë dashuri. Durimi, toleranca dhe kompromisi shihen si elementet kryesore të dashurisë pragma. Dhe sot jemi dëshmitar të pranisë më të madhe të dashurisë pasionante, ku shohim dashuri të mëdha por që shuhën shpejt, ku në fazën e parë duan dhe pranojnë gjithçka tek partneri por më vonë, në një moment të vështirë ata heqin dorë lehtë nga kjo dashuri. Prandaj edhe jemi dëshmitar të shumë divorceve. Dhe më të drejtë psikoloanalisti Erik From thotë se, ne harxhojmë shumë kohë në “të rënit në dashuri” dhe është e nevojshme më shumë të mësojmë se si “të qëndrojmë në dashuri”. Dhe sikur thotë një shprehje se dashuria e vërtetë është një udhëtim i përbashkët nëpër male dhe lugina. Dhe nëse në këtë udhëtim ju ndjeheni të sigurt dhe e dini se mund të mbështeteni në partnerin tuaj, atëherë edhe momentet e vështira nuk do ta zhdukni lidhjen, por do ta forcojnë dhe do ta rrisin atë. Pra, besimi dhe besnikëria janë po ashtu themelore për një marrëdhënie të gjatë dhe të shëndetshme.

Duhet kuptuar se dashuria nuk ka vetëm një fazë, momenti kur njihemi dhe na pëlqen tjetri dhe gjithçka te tjetri na duket perfekte duke ju referuar edhe pamjes, edhe përkushtimit afatshkurtër që më vonë mund të kthehet edhe ne pakënaqësi, por dashuria është një proces i gjatë dhe përputhja e brendshme, respekti, dashuria, pranimi, angazhimi, komunikimi, përgjegjësia, transparencja, emocioni e bëjnë atë një udhëtim të bukur dhe të vërtetë.

Dashuria nuk është as xhelozia as dhimbje, sepse dashuria e vërtetë nuk të bën të vuash.



(Foto: nga Arkivi)

## TESTAMENTI SHPIRTËROR I PAPA BENEDIKTIT XVI

**N**ëse në këtë orë të vonë të jetës sime kthej kokën pas për të shikuar dekadat që përshkova, së pari shoh sa kam shumë arsye për të falënderuar.

Falënderoj para së gjithash vetë Zotin, shpërndarësin e çdo dhurate të mirë, që më dha jetë dhe më priu në çaste të ndryshme pësjellimi, duke më ngritur gjithnjë në këmbë, sa herë filloja të rrëshqisja dhe duke më ndriçuar gjithnjë me dritën e fytyrës së Tij. Ndërsa kthej kokën mbrapa, shikoj e kuptoj se edhe skutat më të errëta e më kapitëse të kësaj rruge, ishin për shpëtimin tim dhe se pikërisht në to Ai më priu mirë.

Falënderoj prindërit e mi, që më dhanë jetën në një kohë të vështirë dhe që me çmimin e flajimeve të mëdha, me dashurinë e tyre, më përgatitën një strehë madhështore e cila, si dritë e kthjelltë, i ndriçon të gjitha ditët

e mia, deri më sot. Besimi i patundur i tim atin mësoi ne, fëmijëve, të besojmë, besim që, si udhërrëfyes, që gjithnjë i patundur në mes të të gjitha arritjeve të mia shkencore; devocioni i thellë dhe mirësia e madhe e nënës sime, është trashëgim, për të cilën nuk mund ta falënderoj kurrë sa duhet. Motra më ndihmoi për dekada, me vetëmohim dhe kujdes plot dashuri; vëllai, me kthjelltësinë e gjykimëve, vendosmërinë e patundur dhe qetësinë e zemrës, më hapi gjithnjë rrugën e më priu; pa shoqërimin e tij të vazhdueshëm nuk do të kisha mundur të gjeja rrugën e duhur.

Falënderoj sinqerisht Zotin për miqtë e shumtë, burra e gra, që Ai i vuri gjithnjë pranë meje; për bashkëpunëtorët në të gjitha fazat e rrugëtimit tim; për mësuesit dhe nxënësit, që m'i dhuroi. Ia besoj të gjithë, mirënjohës ndaj mirësisë së Tij.



Dua ta falënderoj Zotin edhe për atdheun tim të bukur në Ultësirën alpine bavareze, ku pashë gjithnjë shkëlqimin e tejdukshëm të vetë Krijuesit. Falënderoj njerëzit e Atdheut tim, sepse ndër ta munda ta jetoj sërish bukurinë e fesë. Lutem që toka jonë të mbetet tokë besimi dhe ju lutem, të dashur bashkatdhetarë: mos u largoni kurrë nga feja juaj!

Së fundi, falënderoj Zotin për gjithçka të bukur, që munda të jetoj në të tëra etapat e shtegtimimit tim, veçanërisht në Romë dhe në Itali, që u bë Atdheu im i dytë.

Të gjithë atyre, të cilëve u bëra keq në çfarëdo mënyre, u kërkoj falje me gjithë zemër.

Atë që u thashë më parë bashkatdhetarëve të mi, ua them tani të gjithë njerëzve të Kishës, që i besuan shërbimit tim në Kishë: qëndroni të patundur në fe! Mos u pësjtjelloni! Shpesh duket se shkenca - shkencat e natyrës nga njëra anë - dhe ato historike (në veçanti interpretimi i Shkrimit Shenjt) nga ana tjetër - janë në gjendje të ofrojnë rezultate të pakundërshtueshme, në kontrast me fenë katolike. I jetova transformimet e shkencave natyrore që nga kohërat e largëta dhe munda të shoh sesi, përkundrazi, u zhdukën siguritë në dukje kundër fesë, duke

dëshmuar se nuk janë shkenca, por interpretime filozofike, shkencore vetëm në dukje; ashtu siç ndodh edhe në dialogun me shkencat e natyrës, që edhe feja ka mësuar ta kuptojë më mirë kufirin e vlerës së pohimeve të veta e rrjedhimisht, edhe specifikën e saj. Që prej gjashtëdhjetë vjetësh shoqëroj rrugën e Teologjisë, posaçërisht të Shkencave Biblike,

e duke ndjekur pas, breznitë të ndryshme, pashë sesi u shembën teza, që dukeshin të palëkundshme, duke dëshmuar se ishin thjesht hipoteza: breznia liberale (Harnack, Jülicher, etj.), breznia ekzistencialiste (Bultmann etj.), breznia marksiste. Pashë dhe vazhdoj të shikoj se si nga lëmshi i hipotezave, doli dhe po del sërish në pah arsyetimi i fesë. Jezu Krishti është me të vërtetë

***“Pashë dhe vazhdoj të shikoj se si nga lëmshi i hipotezave, doli dhe po del sërish në pah arsyetimi i fesë. Jezu Krishti është me të vërtetë rruga, e vërteta dhe jeta – e Kisha, me të gjitha kufizimet e saj, është me të vërtetë Korpi i Tij”.***

etë rruga, e vërteta dhe jeta - e Kisha, me të gjitha kufizimet e saj, është me të vërtetë Korpi i Tij.

Së fundi, kërkoj përvujtërisht: lutuni për mua, në mënyrë që Zoti, me gjithë mëkatet dhe të metat e mia, të më mirëpresë në banesat e amshuara. Për të gjithë ata, që m'u besuan, del ditë për ditë nga zemra lutja ime!

*Papa Benedikti XVI*



## Mesha shenjte

Mesha shenjte është themeli dhe qendra e jetës tonë të krishterë. Asnjë devocion dhe asnjë përshtirësi tjetër nuk mund ta zëvendësojë kremtimin Eukaristik. Në Misionin tonë, përveç të dielave dhe festave, çdo javë nga dita e martë deri të shtunën, në orën 9:00 kemi kremtimin e Meshës shenjte. Prandaj, nëse gjatë këtyre ditëve të javës ke mundësi për të marrë pjesë në Meshë, mos ja moho vetvetes këtë përvojë takimi me Krishtin dhe me njëri-tjetrin.



(Foto: Nue Tuqi)

## Pagëzimet

Kisha rritet në numër dhe shenjtëri përmes sakramentit të pagëzimit. Çdo të shtunë në



(Foto: Nue Tuqi)

orën 10:00, në Luzern, dhe në çdo vend ku kremtojmë Meshën shenjte sipas datave dhe orëve në kalendar, është mundësia e pagëzimit të fëmijëve tuaj. Lajmërimi është i domosdoshëm!

## Përgatitja për Kurorëzim

Familja e bashkuar është bërthama e një shoqërie dhe Kise të shëndoshë. Përgatitjet për kurorëzim kishtar kanë për qëllim vetëdijesimin ndaj përgjegjësive që të martuarit kanë ndaj njëri-tjetrit dhe familjes. Prandaj i ftojme të gjithë ata që kanë për tu kurorëzuar këtë vit, të lajmërohen në Misionin tonë në Luzern.

Kalendari i takimeve përgatitore për kurorëzim kishtar është në këto data:

26 maj 2023, ora 20:00, në Luzern

2 qershor 2023, ora 20:00, në Luzern

9 qershor 2023, ora 20:00, në Luzern



(Foto: nga Arkivi)

## Përkujtimi i të vdekurve

Kujtimi dhe lutja për të dashurit tanë, që tashmë kanë kaluar në Amshim, është detyrë dhe përgjegjësi e secilit prej nesh, aq më tepër në ditën apo në datën e vdekjes së tyre. Prandaj, ata të cilët dëshirojnë t'i përkujtojnë të vdekurit e tyre me Meshën shenjte, janë të lutur të lajmërojnë së paku dy javë para dhe, mundësisht, të jenë pjesëmarrës në kremtimin e Meshës së kremtuar për të afërmit e tyre.

## Të martet e shna Ndout

Devocioni i 13-të të Marteve kushtuar shna Ndout të Padovës është një traditë e lashtë e Kishës dhe shumë e dashur edhe për besimtarët tanë. Meshët e shenjta në Misionin tonë janë: në Luzern, në orën 9:00 dhe në Emmenbrücke, në orën 19:30.



(Foto: nga Arkivi)

## Qendra e dëgjimit

Duke parë nevojën e shumë njerëzve për t'i dëgjuar dhe këshilluar, kemi vendosur që çdo të shtunë paradite, por, tashmë edhe gjatë javës, të jemi të gatshëm për t'i pranuar të gjithë

ata që paraqitën në Qendrën e dëgjimit. Rezervimi është i detyrueshëm. Takimi zgjat 45 minuta.

## Të premtet e para të muajit

Të premtet e para të muajit ndërlidhen me përsëritësinë e besimtarëve ndaj Zembrës së Krishtit. Çdo të premte të parë të muajit, në orën 18:30, në Luzern, kemi adhurimin e Krishtit në Eukaristi dhe pastaj Meshën shenjtë.

## Statistika të vitit 2022

Pagëzime	54
Kurorëzime	4
Bekime të shtëpive	1000+
Varrime	7
Bamirësi për të sëmurë e të varfër	50'079.50 franga
Për aktivitete të Misionit	58'641.80 franga

## A e dini se:

- Një fëmijë i rrethuar nga kritika, mëson të fajësojë të tjerët dhe të jetë i pakënaqur;
- Një fëmijë i rrethuar nga tallja, mëson të jetë i dyshimtë;
- Një fëmijë i rrethuar nga armiqësia, mëson të mbrohet;
- Një fëmijë i rrethuar nga zemërimi, mëson të shkaktojë dhimbje;
- Një fëmijë i rrethuar nga mosinteresimi, mëson të mos dëgjojë të tjerët;
- Një fëmijë i rrethuar nga mashtrimi, mëson fshehjen;
- Një fëmijë i rrethuar nga turpi, mëson fajin;
- Një fëmijë i rrethuar nga respekti për kufijtë, mëson pavarësinë;
- Një fëmijë i rrethuar nga pranimi, mëson durimin;
- Një fëmijë i rrethuar nga mbështetja, mëson vetëbesimin;
- Një fëmijë i rrethuar nga ndershmëria, mëson ndershmërinë;
- Një fëmijë i rrethuar nga siguria, mëson të besojë;
- Një fëmijë i rrethuar nga dashuria, mëson të japë;
- Një fëmijë i rrethuar nga liria e zgjedhjes, mëson përgjegjësitë.

(J. Hollis)

**Prill 2023****01.04.2023**

18:00 Seminari shpirtëror në Luzern

**02.04.2023**

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Sursee

18:00 Mesha në Giornico TI

**04.04.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**06.04.2023**

20:00 Mesha në Luzern

**07.04.2023**

13:00 Udha e Kryqit në Einsiedeln

19:00 Mundimet e Krishtit në Luzern

**08.04.2023**

Vizita të sëmurve

19:00 Mesha në Iwil

22:00 Mesha në Luzern

**09.04.2023**

10:30 Mesha në Goldau

13:30 Mesha në Emmenbrücke

**10.04.2023**

10:00 Mesha në Luzern

**11.04.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**16.04.2023**

13:30 Luzern

**18.04.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**23.04.2023**

19:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Menznau

**25.04.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**30.04.2023**

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Emmenbrücke

**Maj 2023****02.05.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**05.05.2023**

18:30 E premtja e I e muajit, adhurim dhe Mesha në Luzern

**07.05.2023**

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Sursee

18:00 Mesha në Giornico TI

**09.05.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**13.05.2023**

17:30 Zoja e Fatimes, procesioni me gjitha Misionet në Sursee

20:00 Promovimi i librave në Luzern

**14.05.2023**

3:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Willisau

15:00 Dita e Nënave në Luzern

**16.05.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**17.05.2023**

20:00 Nisja për Lourdes

**21.05.2023**

19:30 Mesha në Sursee

**23.05.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**26.05.2023**

20:00 Takim me të fejuarit në Luzern

**27.05.2023**

SHTEGTIM në Einsiedeln, Mesha në ora 19:00

**28.05.2023**

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Menznau

**29.05.2023**

11:00 GRILL me grupet e Misionit në Luzern

**30.05.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**31.05.2023**

19:30 Përfundimi i muajti Maj në Luthern Bad me Meshën dhe rruzaren

**Qershor 2023****02.06.2023**

18:30 E premtja e I e muajit, adhurim dhe Mesha në Luzern

20:00 Takim me të fejuarit në Luzern

**03.06.2023**

18:00 Mesha në Vetroz

**04.06.2023**

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Sursee

18:00 Mesha në Giornico TI

**06.06.2023**

09:00 Mesha në Luzern

19:30 Mesha në Emmenbrücke

**09.06.2023**

20:00 Takim me të fejuarit në Luzern

**11.06.2023**

3:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Willisau

**13.06.2023**19:30 Festa e Shna Ndout, Mesha në Emmenbrücke  
Pas Meshës Aperò**16.06.2023**

19:00 Zemra e Krisihtit, Mesha në Luzern

**18.06.2023**

10:30 Mesha në Goldau

13:30 Mesha në Sursee

**24.06.2023**

10:00 Përmbyllja e Mësimi të Fesë, Festa në Luzern

20:00 Mbledhja e Këshillit në Luzern

**25.06.2023**

11:00 Mesha në Inwil ZG

13:30 Mesha në Emmenbrücke

17:00 Mesha në Menznau

**29.06.2023**19:30 Shën Pjetri e Shën Pali apostull,  
Mesha në Luzern

# SHTEGTIMI - LOURDES 2023

Shtegtimet gjithmonë janë përvoja të bukura shpirtërore dhe miqësore!

Falënderojmë Hyjin dhe ndërmjetësinë e Virgjërës Mari që edhe këtë vit mund të shtegtojmë te Shpella e Zojës së Bekuar në Lourdes - Francë!

## NISJA:

17. Maj, ora 20:00, nga Luzerni

## KUSHTET PËR REGJISTRIM TË VLEFSHËM:

- Dokument të vlefshëm udhëtimi
- Pagesa e paraparë për shtegtim

## KU MUND TË REGJISTROHENI?

Misioni Katolik Shqiptar Luzern  
Rodteggstrasse 6, 6005 Luzern

Tel: 041 250 52 60 / 079 371 68 91

E-Mail: [albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch](mailto:albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch)

## KTHIMI:

21. Maj, paradite

## ÇMIMI GJITHËPËRFSHIRËS:

350 franga për të rritur

250 franga për 7-12 vjeçar

200 franga për 3-6 vjeçar

## KU MUND TË BËHET PAGESA?

Konto-Nr.:

CH 94 0077 8155 5749 1200 4

Albaner-Mission

Rodteggstrasse 6, 6005 Luzern

# SHTEGTIMI - JERUSALEM 2023

Shtegtimet gjithmonë janë përvoja të bukura shpirtërore dhe miqësore!

Falënderojmë Hyjin dhe ndërmjetësinë e Virgjërës Mari që përsëri mund të shtegtojmë në Tokën e shenjtë - në Jerusalem!

## FLUTURIMI:

9. Tetor, ora 22.45, ZH

## KUSHTET PËR REGJISTRIM TË VLEFSHËM:

- Dokument të vlefshëm udhëtimi me afat udhëtimi 6 muaj
- Për pasaportë kosovare kërkohet viza (Fr. 35 shtesë)

## KU MUND TË REGJISTROHENI?

Misioni Katolik Shqiptar Luzern  
Rodteggstrasse 6  
6005 Luzern

Tel: 041 250 52 60

Natel: 079 371 68 91

E-Mail: [albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch](mailto:albanermission@migrantenseelsorge-luzern.ch)

## KTHIMI:

16. Tetor, ora 21.35, ZH

## ÇMIMI GJITHËPËRFSHIRËS:

1'700 franga

## KU MUND TË BËHET PAGESA?

Konto Nr.:

CH 94 0077 8155 5749 1200 4

Albaner-Mission

Rodteggstrasse 6

6005 Luzern



Don Anton Uka

### Etika e komunikimit

“Libri Etika e komunikimit është një libër tjetër i jashtëzakonshëm, që autori Dr. Don Anton Uka po i dhuron shoqërisë sonë shqiptare, e cila në shumë aspekte mund të krahasohet me Babelin biblik, ku komunikimi paraqitet shumë i vështirë e nganjëherë edhe i pamundshëm. Ky libër dëshiron të ndihmojë njeriun, që si qenie komunikuese është i thirrur ta shërojë paaftësinë e komunikimit, duke gjetur “në Babelin e sotëm një komunikim të vërtetë, të njëmendtë, merren e kuptohen, marrin jehonë dhe simpati”.

Autori i kësaj vepra si studiues i mirëfilltë i veprave të kardinal Carlo Maria Martini, bën një analizë të detajuar të letrave baritore të ish lpushkvit të Milanos me qëllim që të nxjerrë porosinë dhe aktualitetin që ato vazhdojnë të kenë edhe për shoqërinë tonë moderne, të pajisur me mjete të shumta komunikimi, por në anën tjetër, e varfëruar pikërisht për arsye të paaftësisë së komunikimit të asaj fjale dhe me atë fjalë e cila është e aftë t’i dhurojë njeriut bashkëkohor horizonte të reja shprese dhe dashurie. Këtij paradoksi shoqëror në të cilin ndodhemi sot, autori, duke u mbështetur në doktrinën martinjane, synon t’i japë përgjigje të qarta me qëllim që t’iu ofrojë të gjithë atyre që vazhdojnë ta kenë të vështirë komunikimin e mirë, të duhur dhe të sinqertë brenda familjes, shoqërisë, Kishës, brenda botës politike dhe asaj mediatike”.

*Stefan Çapaliku*



Engjëll I. Berisha

### Mes luftës e paqes – Monografi

“Monografia e veprimtarisë me emrin e humanistes, Nënë Terezës, sot e Lumnueme në shoqërinë e shenjtërve, prezanton humanizmin e dhuruesve duke ndarë prej pagës së tyre, prej bizneseve e forma tjera, të cilat ia dedikojnë familjeve, individëve e subjekteve, me ushqime, barna, strehim e shërim në shumë shtete, pa dallime të konfesioneve fetare, pa dallime kombëtare, race e ngjyre, të cilët janë mirënjohës deri te Zoti. Kjo dhe ishte moto e Nënës Terezë.

Janë shënime që paraqet emra të personave nëpër etapa dhe në kohën e themelimit.

Paraqet vlerë monetare të dhuruesve dhe pranuesve.

Raporte të përmbledhura e statistika.

Një historik me vlerë kombëtare që do t’i bëhet udhërrëfyes ndjesisë për të mirën e civilizimit, e për dashurinë e njeriut ndaj krijesës së Zotit. Për dashurinë tonë ndaj vëllazërisë”.

*(Nga parathënia e librit)*

**AZB 6005 Luzern  
Post CH AG**  
Erscheint 4 x jährlich

Redaktionsschluss:  
Nr. 2/2023  
15. Juni 2023

Erscheint im  
Juni 2023

**Impressum**

Misioni Katolik Shqiptar në Luzern  
Katholische Albanische Mission in Luzern

**Verlag und Redaktion**

Dr. Don Anton Uka, Përgjegjës  
Rodteggstrasse 6  
CH-6005 Luzern  
Tel: +41 41 250 52 60  
Fax: +41 41 250 52 67  
Cel: +41 79 371 68 91  
E-Mail: ukas\_cr@hotmail.com  
anton.uka@migrantenseelsorge-luzern.ch

Mitteilungsblatt für die Mitglieder des Vereins  
der Katholischen Albanischen Mission in Luzern.

## ***In memoriam: Hil Kalaj (1956–2022)***

Hil Kalaj lindi më 24 mars 1956 në Grazhdanik të Prizrenit dhe ndërroi jetë më 5 dhjetor 2022, natën e Shën Nikollës në spital në Wolhusen. Hili në vitin 1978 la vendlindjen dhe erdhi për të punuar në Zvicër. I ndjeri la pas vetes bashkëshorten, tre fëmijë e familjarë të tjerë.

Meshën e dritës e ka kremtur don Anton Uka, në kishën e famullisë në Zell, ku Hili ka jetuar mbi 40 vite, kurse pritja dhe lutja për shpirtin e tij ishte në kapelën e kishës, deri sa është përcjellë për Kosovë. Për shoqërinë zvicrane dhe të tjerët është bërë liturgjia e fjalës nga Anna Engel në Zell më 7 janar 2023 dhe pas 40 ditë të vdekjes Meshën shenjte për shpirtin e tij në Sursee e ka kremtur don Anton Uka. Varrimi i Hilit, sipas dëshirës së tij është bërë në Grazhdanik. Meshën shenjte dhe ritet e varrimit i ka udhëhoqur dom Tomë Karrica së bashku me don Kelmend Spaqin. Të pranishëm ishin shumë familjar, miq dhe dashamirë.

I ndjeri Hili ka përjetuar sëmundje të rëndë dhe të gjatë, por si besimtar i mirë dhe i fortë, ka pasur durësë dhe fe të gjallë, duke iu bashkuar dhimbjes dhe

mundimeve të Jezusit. Me ndihmën e Zotit në të cilin është mbështetur është munduar të jetë aktiv, në mënyrë të veçantë me nipin, që e ka dashur shumë i cili sado pak e ka bërë të harrojë dhimbjet e mëdha që ka pasur. Edhe pse me sëmundje të rëndë shtegtoi në Padovë dhe në Lurd, kur edhe pranoi sakramentin e vajimit nga don Kelmend Spaqi. Me dhimbjen e vet të madhe, Hili i është bashkuar dhimbjeve të Krishtit të vuajtur, por edhe besimi se do të ngjallet ashtu si na ka premtuar Krishti, e premtimi i Tij është i vërtetë. Shpresojmë e besojmë se Hili i është bashkur Krishtit, si në dhimbje edhe në lavdinë e tij që nuk ka mbarim.

Familja e Hilit falënderon dhe vlerëson shumë mbështetjen e të gjithë atyre që morën pjesë në varrim dhe shprehën ngushëllime. Pjesëmarrja e madhe e njerëzve në përcjelljen e tij për në shtëpinë e Atit për familjen, ishte një respekt dhe dashuri e madhe që nuk harrohet. Lusim që Zoti t'i shpërblejë të gjithë me huret e tija, kurse Hili pushoftë në paqe!

*Shkruan: Manuela Kalaj, Zug*

## **Të ndihmojmë Misionin tonë!**

**Konto: CH24 0077 8155 5749 1200 3**

**Albaner Mission | Rodteggstrasse 6 | 6005 Luzern**